



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

**THIRRJE PËR APLIKIME PËR POZICION PUNE PËR NJËSINË E ZBATIMIT TË
PROJEKTIT TË FONDIT GLOBAL PËR HIV/TB**

Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale do të fillojë zbatimin e Projektit të Fondit Global për AIDS, Tuberkuloz dhe Malarie, GFATM. Projekti i Fondit Global në Shqipëri do të mbështesë aktivitetet në fushat e parandalimit të HIV dhe TB, përf forcimin e sistemit shëndetësor të shërbimit në të gjitha nivelet, rritjen e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve dhe ndërtimin e sistemeve të qëndrueshme për mbështetjen e aktiviteteve në të ardhmen. Në këtë kuadër, Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, në bashkëpunim me Fondin Global, do të ngrenë Njësinë e Zbatimit të Projektit, për pozicionin e mëposhtëm: Menaxheri i Programit.

I. Afati i fundit i aplikimit: 23.12.2017

Nr. kontakti/email/web: 003542364622; www.shendetesia.gov.al;

Vendndodhja: Programi Kombëtar i TB Spitali Universitar i Tiranës “Shefqet Ndroqi”, Programi Kombëtar i HIV, Instituti i Shëndetit Publik.

Kohëzgjatja: 2 (dy) vjet.

Orari i punës: kohë e plotë.

Periudha e parashikuar e fillimit të punës: 3 Janar 2018.

II. Përshkrimi i punës/Kërkesat thelbësore

1. Menaxheri i Programit

Qëllimi kryesor i punës

Menaxheri i Programit do të japë orientime të përgjithshme për Programet e Fondit Global. Ai/ajo do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e përgjithshme të menaxhimit të programit dhe do të sigurojë përdorimin efikas të burimeve për të arritur këto qëllime dhe objektiva për zbatimin efektiv të programit në përgjithësi, dorëzimin në kohë të raporteve programatike dhe financiare, sipas dispozitave të marrëveshjes së grantit.

Objektivat kryesore

Menaxheri i programit duhet të sigurojë që:

- Burimet e programit janë shfrytëzuar në mënyrën më efektive dhe efikase të mundshme;
- Qëllimet dhe objektivat e programit janë përmbushur brenda afatit të caktuar;
- Është siguruar respektimi rigoroz i procedurave standarde të veprimit dhe udhëzimeve të Grantit të Fondit Global;
- Ekzistojnë sisteme të përshtatshme funksionimi dhe menaxhimi;
- Është mbajtur një marrëdhënie produktive me grupet e tjera përkatëse të interesit;

- Janë prodhuar sipas kërkesave raportet periodike dhe të veçanta për grupet e jashtme të interesit;
- Është siguruar përgatitja dhe shpërndarja në kohë e planit të punës;

Detyrat kryesore gjatë negociatave për Grantin

Koordinimi

- Të koordinojë dhe të komunikojë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, MKV, Mekanizmin Koordinues për Vendin, Fondin Global, LFA-në, Agjentin Lokal të Fondit, organizatat ndërkombëtare, SR-të, nën-përfituesit;
- Të koordinojë punën mes njësisë së programit të Fondit Global dhe drejtorive në Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale;
- Të bashkëpunojë me MKV, Programin Kombëtar të Kontrollit të HIV/AIDS dhe Programin Kombëtar të Kontrollit të TBC për të koordinuar nismat që lidhen me TB-në dhe HIV/AIDS-in, duke përfshirë edhe programet e financuara nga buxheti i shtetit, në mënyrë që të mos ketë mbivendosje të aktiviteteve dhe që burimet të përdoren për të mbuluar mangësitë ekzistuese në financim;
- Të bashkëpunojë me LFA-në dhe të sigurojë të gjithë informacionin e nevojshëm dhe sqarimet përkatëse sipas kërkesave; të sigurojë që LFA-ja dhe grupet e tjera përkatëse të interesit të kenë akses në dokumentet dhe rregulloret, sipas nevojës.

Planifikimi dhe realizimi

- Të koordinojë përgatitjen e një strukture të programit ku të përshkruhet se si projektet brenda një programi do të vënë në jetë kapacitetet dhe arrijnë përfitimet e kërkuara; të sigurojë që planet dhe buxhetet e detajuara të punës me role, aktivitete dhe burime të përshtatshme për PR-në dhe SR-të të përcaktuara qartë të dorëzohen dhe miratohen nga MKV-ja, MSH-ja, LFA-ja dhe Fondi Global;
- Të jetë në krye të realizimit të vlerësimit të kapaciteteve të Përfituesit Kryesor, Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale.
- Të jetë në krye të përgatitjes së dokumenteve për marrëveshjen e grantit, të mbikëqyrë menaxhimin dhe të sigurojë pajtueshmërinë e ndërhyrjeve të Programit me propozimet në Koncept-Notës, politikat shëndetësore vendase dhe kërkesat ndërkombëtare, në bashkëpunim me MSHMS-së dhe partnerë të tjerë vendas dhe të huaj;
- Të negociojë dhe hartojë marrëveshjet për zbatimin e Programit (Grantit), planin e punës, buxhetin, planin e prokurimeve, kuadrin e performancës dhe planin e monitorimit dhe vlerësimit;
- Të garantojë që plani zbatohet dhe programet monitorohen në përputhje me kërkesat e Fondit Global, shtetit dhe ato organizative;
- Të përcaktojë planin e punës dhe të mbikëqyrë aktivitetet e stafit të Programit, të ndërmarrë përditësime periodike të planeve;
- Të përcaktojë afatet e Programit në bashkëpunim të ngushtë me Fondin Global.

Detyrat kryesore gjatë zbatimit të Grantit

- Të jetë në krye të zbatimit të programeve; të mbikëqyrë menaxhimin, zbatimin dhe monitorimin e një programi që përbëhet nga programe të ngjashme të financuara nga Fondi Global; gjatë konsultimeve me Fondin Global, MKV-në dhe qeverinë;
- Të përfaqësojë Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale gjatë negociatave me Fondin Global, Mekanizmin Koordinues Vendor dhe Qeverinë.

- Të koordinojë ngritjen e një strukture menaxhuese në përputhje me kërkesat e Fondit Global dhe ato vendase dhe rekrutimin dhe trajnimin e stafit të Njesisë së Zbatimit të Programit;
- Të garantojë që plani zbatohet dhe programet monitorohen në përputhje me kërkesat e Fondit Global, shtetit dhe ato organizative;
- Të sigurojë pajtueshmërinë e ndërhyrjeve të Programit me politikat shëndetësore vendase dhe kërkesat ndërkombëtare, në bashkëpunim me MSHMS-në dhe partnerë të tjerë vendas dhe të huaj;
- Të sigurojë zhvillimin dhe zbatimin e sistemit të kontabilitetit dhe instrumenteve të menaxhimit financiar për mbajtjen e inventarëve dhe përdorimin e fondeve të programit;
- Të menaxhojë buxhetin në mënyrë efikase;
- Të mbikëqyrë prokurimet e produkteve mjekësore;
- Të koordinojë përgatitjen dhe dorëzimin në kohë të Raporteve të Performancës, Raporteve të Progresit, Kërkesave për Disbursim, Pasqyrave Financiare pranë MKV-së, LFA-së, Fondit Global, MSH-së dhe grupeve të tjera të interesit;
- Së bashku me MKV-në, të koordinojë nismat që lidhen me TB-në dhe HIV/AIDS-in, duke përfshirë edhe programet e financuara nga buxheti i shtetit, në mënyrë që të mos ketë mbivendosije të aktiviteteve dhe që burimet të përdoren për të mbuluar mangësitë ekzistuese në financim;
- Të koordinojë dhe të marrë pjesë së bashku me partnerët në zhvillimin e dokumenteve strategjike dhe të programit, udhëzimet metodologjike, materialet e trajnimit dhe dokumentet e tjera teknike që lidhen me komponentin e sëmundjes;
- Të koordinojë punën mes njesisë së programit të Fondit Global dhe drejtorive në Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale ;
- Të mbikëqyrë performancën e stafit dhe të japë rekomandime për masa përmirësuese, sipas nevojës;
- Të miratojë trajnimet e propozuara për stafin;
- Të mbikëqyrë procesin e shqyrtimit të mbylljes dhe përfundimit të Programit në përputhje me kërkesat e Fondit Global.

Kriteret:

- Të ketë diplomë Master Shkencor në shëndet publik, mjekësi, ekonomi, administrim publik, administrim biznesi ose në ndonjë fushë tjetër të ngjashme;
- Kualifikimet ose studimet jashtë vendit, për menaxhim projektsh/programesh përbëjnë përparësi. Preferohet të ketë gradë shkencore (PHD);
- Të ketë njohuri të thelluara, për çështje që lidhen me popullsinë, demografinë, shëndetin publik, sistemin shëndetësor në Shqipëri, TB-në ose HIV/AIDS-in;
- Të ketë minimalisht 2 (dy) vite përvojë pune dhe eksperiencë të ngjashme në drejtim të menaxhimit/koordinimit/monitorimit dhe vlerësimit të projekteve dhe fondeve buxhetore ku ka pasur rol koordinues/menaxhues/monitorues;
- Të dëshmojë eksperiencë të mëparshme pune, të ketë të paktën 5 (pesë) vite pune në fushën e shëndetit publik apo në fusha të tjera të ngjashme;
- Të ketë përvojë në ndërtimin dhe drejtimin e një ekipi projekti;
- Të ketë njohuri dhe përvojë në krijimin e partneriteteve me institucione, sektorin privat dhe shoqërinë civile;
- Të shkruajë dhe të flasë rrjedhshëm gjuhën shqipe dhe angleze.

Aftësitë:

- Të ketë kapacitete të spikatura për të drejtuar veprime dhe detyra komplekse, përfshirë buxhetimin e veprimtarive të projekteve;
- Të ketë përvojë pune dhe bashkëpunimi me grupe interesi;
- Të ketë aftësi vendimmarrëse me informacione të kufizuara dhe në afate të shkurtëra;
- Të ketë aftësi të identifikojë dhe shmangë rreziqet për zbatimin e projekteve;
- Të ketë aftësi të spikatura komunikuese dhe negociuese;
- Të njohë shumë mirë programin e Qeverisë për shëndetësinë dhe projektet e programet që zbatohen në fushën e shëndetësisë;
- Të ketë aftësi për të zgjidhur konfliktet.

III. Dokumentet që duhen paraqitur:

- Letra e shprehjes së interesit;
- Jetëshkrimi (Curriculum Vitae) e kandidatit;
- Diploma/diplomat e studimeve/studimeve të avancuara universitare ;
- Diploma Master Shkencor/ PHD ;
- Çdo dokument tjetër mbështetës për kualifikimet dhe përvojën në punë ;
- Dëshmi e penalitetit;
- Formular vetëdeklarimi i gjendjes gjyqësore;
- Dëshmi e gjuhës angleze (Për aplikantët që janë diplomuar në universitetet e SHBA, Mbretërisë së Bashkuar dhe universitete të tjera ku mësimet zhvillohen në gjuhën angleze nuk është e nevojshme).

Dokumentet të dërgohen me email në adresën: Natalina.Lesi@shendetesia.gov.al

Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të njoftohen për intervistë.